



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. Prot.

Tiranë, më 06.10.2025

**MBLEDHJA Nr. 39,
Datë 08.10.2025, ora 11:00
e Bordit të ERE-s.**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të “Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020, e ndryshuar dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Mërkurë, datë 08.10.2025, ora 11:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 39 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin Shtator 2025 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.
2. Mbi kërkesën e shoqërisë “GREEN VALUE” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
3. Mbi kërkesën e shoqërisë “GET SOLAR SOLUTION” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
4. Mbi kërkesën e shoqërisë “AGE ERZEN” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet barrësimit) të aseteve fikse të saj.
5. Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 192, datë 12.08.2025, “Për dhënien e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të shoqërisë “SPV BLUE 2” sh.p.k. si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj Banka e Tiranës sh.a., Banka OTP Albania sh.a., Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a. dhe Union Bank sh.a.”.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

**KRYETARI
Petrit AHMETI**